



# Pyetjet më të shpeshta

## Rreth programit "Kurse para për kolegjin"

Versioni i shtjelluar

Viti Shkollor 2025-2026



### 5 gjërat kryesore që familjet duhet të dinë

1. Të gjitha familjet që kanë fëmijë të regjistruar në kopsht, në klasën e parë, të dytë, të tretë ose të katërt në një nga shkollat publike të qytetit të Nju Jorkut (NYC public school) (duke përfshirë edhe shkollat çarter pjesëmarrëse), kanë të drejtën të marrin pjesë në programin "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program), pavarësisht të ardhurave të familjes ose statusit të emigracionit.
2. Nëse fëmija juaj ka të drejtën, ai do të **regjistrohet automatikisht** në program, përveç nëse vendosni të tërhiqeni dhe të mos merrni pjesë.
3. Pas regjistrimit, do të merrni broshurën e mirëseardhjes me informacione se si të aktivizoni llogarinë falas të bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) për fëmijën tuaj, e cila do të ketë një shumë fillestare prej 100 dollarësh nga NYC Kids RISE në emër të fëmijës suaj.
4. Pasi ta aktivizoni atë, mund të ndërmerri edhe hapa të tjerë themelorë, të njohur si "Gurët e themelit" (Building Blocks), për të fituar shpërblime shtesë.
5. Paratë në llogaritë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut mund të përdoren për një sërë shpenzimesh për kolegji ose trajnime për karrierë.

# Lista e përmbajtjes

<b>BAZAT E PROGRAMIT</b>	<b>1</b>
<b>KUALIFIKIMI DHE PJESËMARRJA</b>	<b>3</b>
<b>LLOGARIA E BURSËS SHKOLLORE TË QYTETIT TË NJU JORKUT (NYC SCHOLARSHIP ACCOUNT)</b>	<b>5</b>
<b>LLOGARIA JUAJ PERSONALE E KURSIMEVE PËR KOLEGJ</b>	<b>9</b>
<b>PËRPTHJA E KURSIMEVE</b>	<b>11</b>

Programi "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program) i NYC Kids RISE është një program burse dhe kursimesh i administruar nga NYC Kids RISE Inc., një organizatë jofitimprurëse, në bashkëpunim me (NYC Department of Education) dhe qytetit të Nju Jorkut. NYC Kids RISE nuk është i lidhur me programin "Kurse para për kolegjin 529" (529 Save for College Program) të Nju Jorkut dhe as shpërndarës i autorizuar i tij dhe nuk kërkon investime ose jep këshilla për investime. Qyteti i Nju Jorkut dhe Departamenti i Arsimit të qytetit të Nju Jorkut (NYC Department of Education) nuk japin ndonjë mbështetje ose rekomandim dhe nuk kanë kontroll, nuk zotërojnë ose janë të lidhur me Menaxherin e Programit 529 të Nju Jorkut (NY 529 Program Manager) dhe as me produkte investimi për kolegji ose investime të caktuara, përfshirë ato që familjet mund të mësojnë përmes programit "Kurse para për kolegjin".

**NYC  
KiDS  
RISE™** | **Save for College  
Program**

## BAZAT E PROGRAMIT

### 1. Çfarë është programi "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program) i NYC Kids RISE?

Programi "Kurse para për kolegjin" i NYC Kids RISE është një program burse dhe kursimi i krijuar për ta bërë më të lehtë arsimimin në kolegji dhe formimin profesional për të gjithë nxënësit e shkollave publike të qytetit të Nju Jorkut, pavarësisht të ardhurave të familjes ose statusit të tyre të imigracionit.

Duke filluar nga kopshti, çdo fëmijë i regjistruar në shkollat publike të qytetit të Nju Jorkut (duke përfshirë edhe shkollat çarter pjesëmarrëse) përfiton automatikisht në fillim një llogari bursash shkollore të qytetit të Nju Jorkut prej 100 dollarësh për arsimin e tyre të lartë në të ardhmen, përveç nëse prindërit ose kujdestarët e tyre zgjedhin të mos marrin pjesë në programin "Kurse para për kolegjin". Familjet mund të përfitojnë shpërblime shtesë për bursa që do të kalojnë në këtë llogari, duke hapur dhe/ose lidhur një llogari kursimi për kolegji dhe karrierë që e zotërojnë në emër të fëmijës së tyre përmes programit. Më pas, familjet mund të fillojnë të kursejnë në mënyra dhe shuma që janë të përshtatshme për rrethanat e tyre financiare. Edhe komunitetet mund të kontribuojnë me fonde shtesë në llogaritë e bursave shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) për grupe nxënësish përmes bursave komunitare, për të treguar mbështetjen e tyre ndaj suksesit të çdo fëmije.

Fondet e grumbulluara në llogaritë e bursave shkollore të qytetit të Nju Jorkut investohen në një llogari të *Planit direkt*<sup>1</sup> (Direct Plan<sup>1</sup>) të programit "Kurse para për kolegjin 529" (529 Save for College Program) të qytetit të Nju Jorkut, e cila zotërohet dhe menaxhohet nga NYC Kids RISE, një organizatë jofitimprurëse, në emër të nxënësve pjesëmarrës.

Në tërësi, programi "Kurse para për kolegjin" u mundëson prindërve, kujdestarëve, pjesëtarëve të familjes, miqve, shkollave, komuniteteve, bizneseve dhe qeverisë të punojnë së bashku për të krijuar asete dhe për të mbështetur pritshmërinë për sukses arsimor dhe ekonomik për çdo fëmijë.

---

<sup>1</sup> NYC Kids RISE nuk është i lidhur me programin "Kurse para për kolegjin 529" (529 Save for College Program) të Nju Jorkut dhe as shpërndarës i autorizuar i tij dhe nuk kërkon investime ose jep këshilla për investime. Qyteti i Nju Jorkut dhe Departamenti i Arsimit të qytetit të Nju Jorkut (NYC Department of Education) nuk japin ndonjë mbështetje ose rekomandim dhe nuk kanë kontroll, nuk zotërojnë ose janë të lidhur me Menaxherin e Programit 529 të Nju Jorkut (NY 529 Program Manager) dhe as me produkte investimi për kolegji ose investime të caktuara, përfshirë ato që familjet mund të mësojnë përmes programit "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program).

## 2. Si funksionon pjesa e "bursës" e programit "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program)?

Pasi fëmija juaj të jetë i regjistruar në program, NYC Kids RISE do të krijojë një llogari bursash shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) dhe do të transferojë automatikisht 100 dollarë për arsimin e ardhshëm të fëmijës suaj. Prindërit dhe kujdestarët nuk mund të depozitojnë ose të tërheqin nga këto llogari, të cilat mund të përdoren vetëm për shpenzime të pranueshme për arsimin e lartë nga vetë nxënësi pjesëmarrës, pasi të diplomohet. Me kalimin e kohës, NYC Kids RISE do të ofrojë mundësi që familja juaj të fitojë më shumë para për llogarinë e bursës shkollore të fëmijës suaj. Organizatat e komunitetit, bizneset, fqinjët dhe të tjerë gjithashtu mund të kontribuojnë në llogaritë e bursave të grupeve të nxënësve, për të ndihmuar fëmijën tuaj të arrijë qëllimet e tij për kolegji dhe karrierë.

NYC Kids RISE, një organizatë jofitimprurëse, është zotëruesja dhe menaxhuesja e fondeve të bursave në emër të nxënësve pjesëmarrës dhe i investon ato në NY 529 *Direct Plan*, një lloj llogarie investimi e krijuar posaçërisht për të ndihmuar familjet të kursejnë për arsimin e lartë. Llogaritë e bursave shkollore të qytetit të Nju Jorkut mund të fitojnë ose humbasin vlerë me kalimin e kohës, në varësi të tregjeve financiare dhe performancës së investimit.

Nëse jeni prindi ose kujdestari i një fëmije të kualifikuar, për sa kohë që nuk zgjidhni të mos merrni pjesë në program, NYC Kids RISE do të krijojë dhe financojë këtë llogari bursash në emër të fëmijës suaj. Ju do të merrni një broshurë mirëseardhjeje nga NYC Kids RISE kur të krijohet llogaria e bursës së fëmijës suaj. Për të aktivizuar dhe parë fondet e bursës që mbliidhen me kalimin e kohës në llogarinë e bursës së fëmijës suaj:

- Ne **NUK** do t'ju kërkojmë që të depozitoni para
- Ne **NUK** do t'ju kërkojmë që të jepni numrin e sigurimeve shoqërore (Social Security Number, SSN), numrin e identifikimit të tatimpaguesit (Individual Taxpayer Identification Number, ITIN), të dhëna të llogarisë bankare ose të kartës së kreditit
- Ne **NUK** do t'ju kërkojmë që të jepni informacion mbi gjendjen tuaj ekonomike ose statusin e imigracionit
- **NUK** kërkohet niveli i të ardhurave maksimale ose minimale për të qenë pjesë e programit

## 3. Si funksionon pjesa e "kursimeve" e programit "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program)?

Pasi fëmija juaj të ketë llogarinë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account), do të merrni informacione të mëtejshme se si të krijoni një plan kursimi për kolegji dhe karrierë që është i duhuri për ju dhe familjen tuaj. Për të shtuar fondet e investuara në llogarinë e bursës shkollore së fëmijës suaj, mund të hapni dhe/ose të lidhni një llogari kursimi për kolegji dhe karrierë që e zotëroni ju në emër të fëmijës suaj përmes programit.

Ndryshe nga llogaria e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut, e cila zotërohet dhe menaxhohet nga NYC Kids RISE për të ardhmen arsimore të fëmijës suaj, llogaria që keni lidhur zotërohet nga familja juaj. Ju, të afërmit ose miqtë tuaj mund të kontribuoni drejtpërdrejt në këtë llogari. Në varësi të llojit të llogarisë së kursimeve që zgjidhni, familja juaj mund të ndjekë bilancin e vet të kursimeve së bashku me llogarinë e bursës shkollore së fëmijës, përmes platformës virtuale "Gjurmuesi i kursimeve" (Savings Tracker) i NYC Kids RISE.

Mësoni rreth opsioneve për llogaritë e kursimit, duke vizituar faqen [nyckr.org/options-faq](http://nyckr.org/options-faq); duke marrë pjesë në një seancë virtuale të NYC Kids RISE në [nyckr.org/events-faq](http://nyckr.org/events-faq); duke telefonuar në linjën tonë të ndihmës në nr. 833-KID-RISE (833-543-7473); duke na shkruar në [info@nyckidsrise.org](mailto:info@nyckidsrise.org) ose duke rezervuar një takim për të biseduar me një përfaqësues të NYC Kids RISE.

Gjithashtu, mund të rezervoni një takim për konsulencë financiare falas në një nga Qendrat e Fuqizimit Financiar (Financial Empowerment Center) të qytetit të Nju Jorkut. Rezervoni takim në: [nyc.gov/talkmoney](http://nyc.gov/talkmoney).

## 4. Pse u krijua programi "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program)?

Të kursesh para për të ardhmen arsimore të një fëmije mund të jetë e vështirë. Për shumë familje, dërgimi i fëmijëve në kolegji mund të duket i paarrtshëm. NYC Kids RISE, në bashkëpunim me qytetin e Nju Jorkut dhe shkollat publike të tij, e nisi programin "Kurse para për kolegjin" për t'i ndihmuar familjet të fillojnë të kursejnë dhe të planifikojnë për kolegji dhe formim profesional për fëmijën që në ditën e tij të parë të shkollës. Sipas hulumtimeve konstatohet se fëmijët që kanë një llogari kursimi për kolegji prej 1 deri në 500 dollarë kanë tri herë më shumë gjasa të regjistrohen në kolegji dhe më shumë se katër herë që të diplomohen. Konstatohet gjithashtu se fëmijët që frekuentojnë kolegjin kanë më shumë të ardhura gjatë jetës së tyre dhe kanë më pak gjasa të jenë të papunë.

## KUALIFIKIMI DHE PJESËMARRJA

### 5. Kush kualifikohet për programin “Kurse para për kolegjin” (Save for College Program)?

Duke filluar nga viti shkollor 2025–2026 (school year 2025-2026), çdo fëmijë në kopsht, në klasën e parë, të dytë, të tretë dhe të katërt, i regjistruar në shkollat publike të Qytetit të Nju Jorkut (duke përfshirë edhe shkollat çarter pjesëmarrëse), mund të marrë pjesë në program, pavarësisht nga të ardhurat ose statusi i imigracionit të familjes.

Çdo fëmijë nga kopshti deri në klasën e pestë në 39 shkollat pilote të Zonës Gjeografike të Distriktit Shkollor 30 (School District 30) është gjithashtu i kualifikuar për pjesëmarrje.

Për të qenë i regjistruar në programin “Kurse para për kolegjin” nxënësi duhet të ndjekë një shkollë pjesëmarrëse për të paktën 60 ditë. Nëse keni zgjedhur të mos regjistroheni në program, fëmija juaj i kualifikuar do të regjistrohet automatikisht në këtë program në shtator ose janar. NYC Kids RISE do të krijojë një llogari bursash shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) me një shumë fillestare prej 100 dollarësh në emër të fëmijës suaj.

### 6. Si të marr pjesë?

Nëse fëmija juaj është i kualifikuar, është shumë e lehtë të filloni me programin “Kurse para për kolegjin” (Save for College Program). Ja, mënyra:

- **Thjesht mos ndërmerrni asnjë veprim** kur të njoftoheni nga shkolla e fëmijës tuaj se ka filluar periudha për të zgjedhur që të mos merrni pjesë (në atë kohë do të merrni informacion mbi mënyrën se si funksionon procesi i mospjesëmarrjes).
- Pasi të përfundojë periudha e zgjedhjes për të mos marrë pjesë, fëmija juaj do të regjistrohet automatikisht në programin “Kurse para për kolegjin” dhe NYC Kids RISE do të krijojë një llogari bursash shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account), me një shumë fillestare prej 100 dollarësh në emër të fëmijës suaj.
- Do të merrni një **broshurë mirëseardhjeje** nga NYC Kids RISE me informacione dhe udhëzime shtesë. Nëse zgjidhni të merrni pjesë në program në vjeshtë, mund të prisni të aktivizoni llogarinë e fëmijës suaj, duke filluar nga janari i vitit të ardhshëm. (Afati për këtë aktivizim mund të ndryshojë nëse regjistrimi bëhet në një datë të mëvonshme).
- Pasi të merrni broshurën e mirëseardhjes, vizitoni faqen [nyckr.org/activate-faq](https://nyckr.org/activate-faq) për të **aktivizuar** llogarinë e bursës shkollore nga qyteti i Nju Jorkut për fëmijën tuaj. Pasi të regjistroheni në platformën në internet “Gjurmuesi i kursimeve” (Savings Tracker), do të mund të ndiqni ecurinë dhe bilancin e llogarisë së bursës me kalimin e kohës. Do të informoheni gjithashtu mbi hapat e tjerë kryesorë që duhet të ndërmerrni në kuadër të programit.

### 7. Kur mund ta aktivizoj llogarinë falas të bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) për fëmijën tim?

**Fëmija im ka filluar së fundmi për herë të parë kopshtin, klasën e 1-rë, të 2-të, të 3-të ose të 4-t në një shkollë publike të qytetit të Nju Jorkut (ose një shkollë çarter pjesëmarrëse) në vjeshtën e vitit 2025:**

Ju mund ta aktivizoni dhe shikoni llogarinë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut të fëmijës suaj në **janar 2026!** Shkolla juaj dhe NYC Kids RISE do t’ju njoftojnë kur llogaria e fëmijës suaj të jetë gati për t’u aktivizuar.

Nëse keni aktivizuar tashmë një llogari burse shkollore të qyteti të Nju Jorkut për një fëmijë tjetër, mund të hyni sërish në “Savings Tracker” në [nyckr.org/log-in-faq](https://nyckr.org/log-in-faq) dhe të shtoni fëmijën tuaj tjetër të kualifikuar në janar.



Për momentin, mësoni më shumë rreth programit në [nyckr.org/start-faq](https://nyckr.org/start-faq) ose jini pjesë e një seance virtuale në [nyckr.org/events-faq](https://nyckr.org/events-faq).

**Fëmija im është aktualisht në klasën e 1-rë, e 2-të, e 3-të ose e 4-t dhe ka ndjekur një shkollë publike të qytetit të Nju Jorkut (ose një shkollë çarter pjesëmarrëse) gjatë School Year 2024-2025:**

**Urime!** Nëse nuk jeni tërhequr nga programi, fëmija juaj tashmë ka një llogari falas të bursave shkollore të qytetit të Nju Jorkut me një shumë **fillestare prej \$100** për kolegjin dhe formimin profesional. Ndiqni hapat më poshtë për ta aktivizuar dhe parë llogarinë si dhe **për të përfituar një shpërblim shtesë prej 25 dollarësh.**



Vizitoni: [nyckr.org/register-faq](https://nyckr.org/register-faq). Vendosi kodin postar të vendbanimit të fëmijës, datëlindjen dhe numrin e ID-së së nxënësit. Pastaj klikoni “Submit” (Dërgo). Mund të kërkonte ndihmë edhe nga shkolla juaj!

## 8. Si ndikon statusi i emigracionit fëmijën tim që ai të marrë pjesë në program?

Nuk ndikon! Të gjithë nxënësit e kualifikuar mund të marrin pjesë në programin “Kurse para për kolegjin” (Save for College Program) pavarësisht statusit të emigracionit.

Familjet **nuk** kanë nevojë të japin numrin e sigurimeve shoqërore (SSN) ose numrin individual të identifikimit tatimor (ITIN) që fëmija i tyre të regjistrohet në program dhe të përfitojë një llogari bursash nga qyteti i Nju Jorkut (NYC Scholarship Account).

Megjithatë, nëse keni ndërmend të hapni një llogari kursimi për kolegji dhe karrierë që ju e zotëroni në emër të fëmijës, për të kursyer përkrah llogarisë së bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut, ju lutemi vini re se për hapjen e kësaj llogarie kërkohet numri SSN ose ITIN. Për më tepër, nëse vendosni të hapni dhe lidhni një NY 529 *Direct Plan* si opsion llogarie kursimi, duhet të respektoni përkufizimin e Shërbimit të Ardhurave të Brendshme (Internal Revenue Service, IRS) për qytetarët amerikanë ose banorët e përhershëm që është dhënia e një adrese të verifikuar në SHBA.

**Nuk** është e nevojshme të hapni një llogari personale tuajën që fëmija të ketë llogarinë falas të bursës, e cila krijohet dhe menaxhohet nga NYC Kids RISE në emër të fëmijës.

## 9. Nëse nuk tërhiqem, çfarë informacioni merr NYC Kids RISE për mua dhe fëmijën tim për të regjistruar fëmijën në programin “Kurse para për kolegjin” (Save for College Program)?

NYC Kids RISE merr informacionin e mëposhtëm nga shkollat publike të qytetit të Nju Jorkut për çdo nxënës pjesëmarrës:

- Numrin e identifikimit të nxënësit, unik për programin;
- Emrin dhe mbiemrin e nxënësit;
- Datëlindjen e nxënësit;
- Adresën e banimit të nxënësit;
- Nëse ndryshon adresa e banimit të nxënësit;
- Numrin e telefonit të shtëpisë të nxënësit;
- Emrin e shkollës së nxënësit;
- Klasën aktuale të nxënësit;
- Gjuha(ët) që flitet(n) në shtëpinë e nxënësit;
- Nëse nxënësi është transferuar në ndonjë shkollë tjetër, brenda ose jashtë sistemit të shkollave publike të qytetit të Nju Jorkut.

NYC Kids RISE merr gjithashtu informacion për një ose të dy prindërit ose kujdestarë ligjorë për çdo nxënës pjesëmarrës si:

- Numrin e identifikimit të prindit, unik për programin;
- Emrin dhe mbiemrin e prindit ose kujdestarit;
- Adresën e emailit të prindit ose kujdestarit;
- Numrin e celularit dhe/ose të ndonjë numri tjetër.

Ky informacion është i ngjashëm me të dhënat që jepni në “kartën blu” (“blue card”) kur regjistroni fëmijën në shkollë. Këto të dhëna i mundësojnë NYC Kids RISE të krijojnë llogarinë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) për çdo fëmijë pjesëmarrës, si dhe të caktojë shumën fillestare prej 100 dollarësh për secilin. NYC Kids RISE ndjek udhëzime të rrepta për ruajtjen e privatësisë dhe konfidencialitetit të dhënave të familjeve.

## 10. Si përdoren të dhënat tona personale?

Këto të dhëna bazë për familjet pjesëmarrëse përdoren për të krijuar llogarinë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) për nxënësin; për të kontaktuar familjet në lidhje me programin “Kurse para për kolegjin” (Save for College Program), si dhe për të vlerësuar suksesin e programit.

## 11. Çfarë është VistaShare dhe si lidhet me programin “Kurse para për kolegjin” (Save for College Program)?

VistaShare është një kompani teknologjike, e kontraktuar nga NYC Kids RISE, që ofron një program kompjuterik për ruajtjen e sigurt të dhënave personale të nxënësve dhe prindërve/kujdestarëve dhe për krijimin e llogarive të bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account). Softueri i VistaShare, i quajtur “Gjurmuesi i kursimeve” (Savings Tracker), u mundëson pjesëtarëve të autorizuar të familjes që të shikojnë llogarinë e bursës së fëmijës së tyre dhe, nëse dëshirojnë, të lidhin një llogari të tyre të kursimeve për kolegji dhe karrierë me atë të fëmijës.

## 12. Çfarë të dhënash personale të miat dhe të fëmijës tim do të marrë VistaShare?

VistaShare do të ketë akses në softuerin që ruan të dhënat e pjesëmarrësve, për të ofruar mbështetje teknike. Ky softuer ruan të dhënat bazë për familjet të siguruar nga shkollat publike të qytetit të Nju Jorkut, vlerën e fondeve të bursës të caktuar për secilin pjesëmarrës, si dhe të dhëna nga llogaria e kursimeve që një familje ka lidhur me llogarinë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) për fëmijët e saj.

### 13. Po nëse nuk dëshiroj të marr pjesë?

Për t'i treguar shkollës suaj që nuk dëshironi që fëmija juaj të marrë pjesë në programin "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program), duhet të dorëzoni një formular të nënshkruar për mospjesëmarrje ose përmes llogarisë suaj të bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut brenda 30 ditësh. Nëse ndërmerrni një nga këto hapa, fëmija juaj nuk do të ketë një llogari të bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account), shumë filltare prej 100 dollarësh ose fonde në të ardhmen. Për më shumë hollësi, ju lutemi referojuni formularit të mospjesëmarrjes së fëmijës suaj ose vizitoni faqen e shkollave publike të qytetit të Nju Jorkut [nyckr.org/NYCPS](http://nyckr.org/NYCPS).

### 14. Nëse nuk dua të marr pjesë tani në programin "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program), a mund ta regjistroj fëmijën tim më vonë?

Po. Prindërit ose kujdestarët që kanë zgjedhur të mos marrin pjesë, por më vonë ndryshojnë mendim, mund ta regjistrojnë fëmijën e tyre sërish në një datë të mëvonshme. Familjet kanë afat që ta regjistrojnë sërish fëmijën e tyre deri në fund të klasës së pestë. Për më shumë informacione specifike, vizitoni: [nyckr.org/NYCPS](http://nyckr.org/NYCPS).

### 15. A mund ta anuloj pjesëmarrjen e fëmijës tim në programin "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program) pas afatit të njoftimit për mospjesëmarrje?

Po. Ju mund të anuloni pjesëmarrjen e fëmijës tuaj edhe pasi të jetë regjistruar fillimisht. Për udhëzime specifike, vizitoni: [nyckr.org/NYCPS](http://nyckr.org/NYCPS).

## LLOGARIA E BURSËS SHKOLLORE TË QYTETIT TË NJU JORKUT (NYC SCHOLARSHIP ACCOUNT)

### 16. Për çfarë mund të përdoren paratë në llogarinë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account)?

Paratë në këtë llogari investohen në NY 529 *Direct Plan* dhe mund të përdoren për një sërë shpenzimesh të pranueshme të arsimit të lartë. Edhe pse llogaria 529 quhet llogari kursimi për kolegji, ajo mund të përdoret për shpenzime të pranueshme të arsimit të lartë në çdo institucion pjesëmarrës në SHBA dhe jashtë saj. Përveç kolegeve dhe universiteteve tradicionale katërvjeçare, institucione të tjera pjesëmarrëse përfshijnë: kolegjet komunitare, shkollat profesionale dhe teknike, programet e kualifikuara të praktikës së punës si dhe ato

virtuale të diplomave. Fondet e bursës mund të përdoren për tarifat e shkollimit, tarifat e tjera akademike, pajisjet, disa shpenzime për strehim dhe ushqim dhe madje edhe për libra, të cilët shpesh nuk mbulohen nga bursa të tjera. Për një listë të plotë të shpenzimeve të pranueshme për arsimin e lartë, vizitoni: [nysaves.org](http://nysaves.org).

Nëse një nxënës nuk i përdor fondet e llogarisë së bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut brenda 20 viteve nga përfundimi i kopshtit, fondet i kthehen NYC Kids RISE për të mbështetur nxënës të tjerë të ardhshëm në programin "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program).

Paratë në këtë llogari nuk mund të përdoren për asnjë shpenzim nga kopshti deri në klasën e 12-të, përfshirë edhe ato që janë të pranueshme sipas ligjit federal.

### 17. Çfarë ndodh me llogarinë e bursës shkollore të fëmijës tim nëse largohemi nga distrikti aktual i shkollës para se fëmija të përfundojë shkollën e mesme?

Pasi fëmija juaj të jetë pajisur me një llogari bursash shkollore nga qyteti i Nju Jorkut (NYC Scholarship Account), ai vazhdon ta përdorë atë llogari edhe nëse transferohet në çdo distrikt tjetër publik ose shkollë çarter pjesëmarrëse brenda qytetit të Nju Jorkut. Fëmija juaj gjithashtu vazhdon të jetë i kualifikuar për të gjitha përfitimet që burojnë nga pjesëmarrja në programin "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program). Nëse fëmija juaj largohet nga sistemi i shkollave publike të qytetit të Nju Jorkut, ai do të vazhdojë të mund të përdorë fondet që ndodhen tashmë në atë llogari, por nuk do të jetë më i kualifikuar për të fituar shpërblime të tjera.

### 18. Si mund ta shoh bilancin e llogarisë së bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) për fëmijën tim?

Ju mund të shihni llogarinë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut të fëmijës suaj në internet, duke vizituar: NYC Kids RISE Savings Tracker "Gjurmuesi i kursimeve" (Savings Tracker) në [nyckr.org/register-faq](http://nyckr.org/register-faq). Ndiqni udhëzimet hap pas hapi për të krijuar një profil dhe për të parë bilancin e llogarisë së bursës.

### 19. Çfarë është "Numri i identifikimit të nxënësit" dhe pse duhet të regjistrohem në "Savings Tracker"?

Numri i Identifikimit të nxënësit është një numër identifikimi i caktuar nga shkollat publike të qytetit të Nju Jorkut për çdo nxënës në sistemin publik shkollos të qytetit. Për "Savings Tracker" kërkohet numri i identifikimit të nxënësit për të verifikuar identitetin tuaj dhe për të mbrojtur privatësinë e të dhënave të fëmijës suaj. Ju mund ta gjeni këtë numër në

raportin e vlerësimit të nxënësit, duke hyrë në llogarinë tuaj të shkollave të qytetit të Nju Jorkut në [mystudent.nyc](http://mystudent.nyc) ose duke pyetur drejtuesit e shkollës së fëmijës suaj. Vini re se NYC Kids RISE nuk do të ketë kurrë akses në këtë numër identifikimi.

## 20. Si e ndihmojnë kursimet e vogla fëmijën tim që ai të arrijë synimet për kolegji dhe karrierë?

Fëmijët që kanë një llogari kursimi për kolegji dhe një plan për të ndjekur arsimin e lartë kanë më shumë gjasa të frekuentojnë dhe të diplomohen nga kolegji. Sipas hulumtimeve konstatohet se fëmijët që kanë një llogari kursimi për kolegji nga vetëm 1 deri në 500 dollarë, kanë tri herë më shumë gjasa të regjistrohen në kolegji dhe mbi katër herë më shumë gjasa të fitojnë një diplomë universitare. Shpresa është që llogaria e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) e nxënësve pjesëmarrës të rritet me kalimin e kohës, përmes shpërblimeve shtesë dhe bursave komunitare (në varësi të fitimeve ose humbjeve të mundshme nga investimet), duke e bërë më të lehtë arsimimin në kolegji dhe formimin profesional për çdo fëmijë.

## 21. Si mund të fitoj më shumë të ardhura për bursa për fëmijën tim?

NYC Kids RISE do të ofrojë mundësi që familjet të fitojnë shpërblime shtesë për llogarinë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) të fëmijës së tyre. Tre shpërblimet e para jepen për përmbushjen e të ashtuquajturave "3 gurët e themelit" (3 Building Blocks). Këto tre hapa përfaqësojnë bazën për një bashkëpunim afatgjatë për të kursyer së bashku për të ardhmen e fëmijës suaj. Përveç shumë fillestare prej 100 dollarësh në llogarinë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut të fëmijës suaj, NYC Kids RISE do të ofrojë një shpërblim prej 25 dollarësh për secilin nga këta "Gurët e themelit" të arritur nga familja.



### Guri 1 i themelit (Building Block 1)

Aktivizoni dhe shikoni llogarinë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) në [nyckr.org/register-faq](http://nyckr.org/register-faq).



### Guri 2 i themelit (Building Block 2)

Hapni dhe lidhni llogarinë tuaj të kursimeve për kolegji dhe karrierë që zotëroni në emër të fëmijës tuaj, për të kursyer së bashku me llogarinë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account). Zgjidhni një nga dy opsionet që mund t'i lidhni me llogarinë e bursës së fëmijës suaj. Mësoni më shumë në: [nyckr.org/options-faq](http://nyckr.org/options-faq).



### Guri 3 i themelit (Building Block 3)

Depozitoni të paktën 5 dollarë në llogarinë tuaj të lidhur të kursimeve për kolegji dhe karrierë.

Duke filluar nga dita e parë e klasës së parë, familjet që kanë arritur "3 gurët e themelit" do të kualifikohen për "**Të njëjtën shumë të depozituar nga ju**". NYC Kids RISE do të ofrojë po aq sa depozitoni në llogarinë tuaj të lidhur të kursimeve për kolegji dhe karrierë dollar për dollar, deri në shumën prej 100 dollarësh.

Shpërblimet për "Gurët e themelit" (në total 75 dollarë) dhe përputhjen e shumë kursimeve (100 dollarë) janë të disponueshme deri në fund të klasës së pestë, me përjashtim të nxënësve pjesëmarrës që janë në klasë të pestë ose më të rritur dhe që u regjistruan në program, ndërsa frekuentonin një nga 39 shkollat pilot në Distriktin 30 gjeografik (District 30). Këta nxënës mund të vazhdojnë të fitojnë shpërblime për arritjen e "3 gurëve të themelit" dhe përputhjen e shumë kursimeve deri në ditën e fundit të klasës së tetë. Aktualisht, fëmijët që kanë filluar kopshtin për vitin shkollor (school year) 2021-2022; klasën e parë për 2022-2023; klasën e dytë për 2023-2024; klasën e tretë për 2024-2025 ose klasën e katërt për 2025-2026, janë të kualifikuar vetë për shpërblimet deri në fund të klasës së pestë.

Për shpërblime të tjera familjet pjesëmarrëse do të njoftohen në të ardhmen.

Pasi fëmija juaj të jetë pajisur me një llogari bursash shkollore nga qyteti i Nju Jorkut, ai vazhdon ta përdorë atë llogari edhe nëse transferohet në çdo distrikt tjetër publik ose shkollë çarter pjesëmarrëse në qytetin e Nju Jorkut. Fëmija juaj gjithashtu vazhdon të jetë i kualifikuar për të gjitha përfitimet që burojnë nga pjesëmarrja në program. Nëse fëmija juaj largohet nga sistemi i shkollave publike të qytetit të Nju Jorkut, ai do të vazhdojë të mund të përdorë fondet që ndodhen tashmë në atë llogari, por nuk do të jetë më i kualifikuar për të fituar shpërblime të tjera.

## 22. Çfarë janë bursat komunitare? Si funksionojnë ato?

Bursat komunitare janë mundësi që organizatat lokale, bizneset, fqinjët dhe sistemet e ndryshme të bashkëpunojnë për të investuar më shumë në të ardhmen e çdo fëmije dhe si tregues që komuniteti mbështet rrugën e suksesit të tyre. Këto bursa janë kontribute financiare nga komuniteti që dhurohen për llogaritë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) për nxënësit, përmes donacioneve drejtuar NYC Kids RISE. 100% e kontributeve ndahen drejtpërdrejt dhe në mënyrë të barabartë në llogaritë e bursave shkollore të qytetit të Nju Jorkut për nxënësit.

Bursat komunitare i nxisin familjet:

- **Të veprojnë dhe kursejnë:** Ato janë një arsye edhe më shumë që familjet të aktivizojnë llogaritë e bursave shkollore të qytetit të Nju Jorkut për fëmijët e tyre, për të parë fondet në llogari dhe për të ndërmarrë hapa të mëtejshëm për të fituar më shumë shpërblime.
- **Të krijojnë pasuri dhe asete:** Ato u ofrojnë nxënësve asete të prekshme financiare për kolegji dhe formim profesional, ndërkohë që kontribuojnë në krijimin e pasurisë në komunitete dhe në luftën kundër hendekut të pasurisë racore.
- **Të tregojnë mbështetjen e mbarë komunitetit për brezat e rinj:** Bursat komunitare shërbejnë për t'u treguar fëmijëve se komuniteti i tyre beson në ëndrrat e tyre për arsimin e lartë dhe karrierën! Përmes bursave komunitare, komunitetet përforcojnë pritshmërinë e suksesit për të gjithë fëmijët dhe u tregojnë familjeve që nuk janë të vetme për të kursyer për të ardhmen.
- **Të fuqizojnë komunitetet përmes kapitalit të përbashkët social:** Bursat komunitare bashkojnë shkollat, familjet dhe institucionet e komunitetit që kanë rëndësi në jetën e një fëmije. Me thellimin e këtyre lidhjeve, ne ndërtojmë komunitete më të forta.

Për të mësuar më shumë rreth programit "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program), vizitoni: [nyckr.org/d30brief-faq](http://nyckr.org/d30brief-faq); dhe shikoni shembuj të bursave të mëparshme komunitare në: [nyckr.org/CSinfo-faq](http://nyckr.org/CSinfo-faq).

## 23. A mund të kursej vetë paratë e mia në llogarinë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) të fëmijës tim?

Jo, familjet nuk mund të depozitojnë para në llogaritë individuale të bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut. NYC Kids RISE i nxit familjet të hapin dhe të lidhin një llogari të tyre për kurse për kolegji dhe karrierë përmes platformës dhe të fillojnë të kontribuojnë në atë llogari. Komuniteti, përfshirë organizatat dhe bizneset, mund të kontribuojnë në llogaritë e bursave shkollore të një grupi nxënësish përmes një donacioni te NYC Kids RISE.

## 24. Çfarë është llogaria 529?

Llogaria 529 është krijuar posaçërisht për të ndihmuar familjet të kursejnë për arsimin e lartë. Paratë në llogarinë 529 mund të shtohen me kalimin e kohës dhe janë me përfitime tatimore, përfshirë heqjen e tatimit mbi të ardhurat dhe zbritje të mundshme të tatimit shtetëror mbi të ardhurat. Megjithatë, paratë në një llogari 529 nuk janë të garantuara se do të shtohen dhe gjithashtu ato mund të humbin vlerë. NY 529 *Direct Plan* është plan kursimi për kolegji i administruar nga Zyra e Inspektorit Financiar të Shtetit të Nju Jorkut (Office of

the Comptroller of the State of New York) dhe nga Korporata e Shërbimeve të Arsimit të Lartë të Nju Jorkut (New York Higher Education Services Corporation).

## 25. Kush vendos se si investohen fondet në llogarinë e bursës?

NYC Kids RISE zotëron dhe menaxhon llogaritë e bursave shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) dhe vendos se si do të investohen ato. Për më shumë informacion mbi NY 529 *Direct Plan* dhe opsionet e tij të investimit, vizitoni: [nysaves.org](http://nysaves.org) ose telefononi në nr. 877-NYSAVES (877-697-2837).

## 26. A do ta pengojë kjo bursë fëmijën tim të marrë bursa të tjera në të ardhmen?

Zotërimi i një llogarie të bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) dhe përfitimi i një burse komunitare përmes programit "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program) të NYC Kids RISE nuk duhet ta pengojë fëmijën tuaj të përfitojë bursa të tjera nga programe ose organizata të tjera në të ardhmen. Megjithatë kjo mund të varet nga kushtet e atyre bursave të tjera. Ju lutemi, lexoni me kujdes kushtet e atyre bursave.

## 27. Si lidhet programi "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program) me bursën "Drejt Ekselencës" (Excelsior Scholarship), program i diplomimit pa tarifa i shtetit të Nju Jorkut?

Paratë në llogarinë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) mund të përdoren për më shumë, sesa vetëm për tarifën shkollore. Nëse një nxënës kualifikohet për arsim falas në një nga universitetet "CUNY" ose "SUNY" përmes bursës "Excelsior", ai mund të përdorë fondet nga llogaria e bursës për të mbuluar shumë nga shpenzimet e tjera të kolegjit. Kjo përfshin libra, materiale shkollore, kompjuterë dhe disa tarifa për strehim dhe ushqim. Gjithashtu, llogaria e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut mund të përdoret në shumicën e kolegjeve dhe programeve të trajnimit profesional dyvjeçare dhe katërvjeçare në Shtetet e Bashkuara, si dhe në disa shtete të huaja.

## 28. Si mund t'i përdorë fëmija im këto fonde kur të shkojë në kolegji?

NYC Kids RISE do t'u ofrojë nxënësve dhe prindërve/kujdestarëve të tyre informacion mbi mënyrën e përdorimit të llogarisë së bursës shkollore kur nxënësit të jenë në shkollë të mesme.

## 29. A ka një afat për përdorimin e fondeve në llogarinë e bursës?

Afati për të përdorur fondet në llogarinë e bursës së qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) është 20 vjet pas përfundimit të kopshtit nga fëmija. Për shembull, fëmijët që përfundojnë kopshtin në qershor 2025 do të mund të aplikojnë dhe të përdorin fondet e bursës për shpenzime të pranueshme të kolegjit ose formimit profesional deri më 30 qershor 2045. Nëse mbeten fonde të papërdorura pas këtij afati, ato fonde do të kthehen te NYC Kids RISE në mbështetje të programit "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program) në vitet e ardhshme.

## 30. A mund të transferohen fondet nga llogaria e bursës së fëmijës tim te një fëmijë tjetër nëse ato nuk përdoren?

Jo, llogaria e bursës është caktuar posaçërisht për arsimin e fëmijës suaj pas shkollës së mesme. Fondet në këtë llogari nuk mund të transferohen te një fëmijë tjetër.

## 31. Si ndikon zotërimi i një llogarie bursash shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) në kualifikimin për fonde publike?

Duke qenë se llogaritë e bursave shkollore të qytetit të Nju Jorkut zotërohen dhe menaxhohen nga NYC Kids RISE, zotërimi i kësaj llogarie **nuk** ndikon që një nxënës ose familje të aplikojë për fonde publike. Nëse një familje kursen para në llogarinë e saj të kursimeve për kolegji dhe karrierë, ai aset mund të ndikojë në disa përfitime të caktuara. Për më shumë informacion se si kontributet në llogarinë tuaj të kursimeve për kolegji dhe karrierë mund të ndikojnë në përfitimet tuaja, vizitoni: [nyckr.org/infomaterials-faq](https://nyckr.org/infomaterials-faq) dhe shkarkoni fletëpalosjen programi "Kurse para për kolegjin dhe përfitimet nga fondet publike" ("The Save for College Program and Public Benefits").

## 32. Si ndikon pasja e një llogarie bursash shkollore në qiranë time nëse kam strehim të siguar nga Autoriteti i Banesave të Qytetit të Nju Jorkut (New York City Housing Authority, NYCHA)?

Duke qenë se llogaritë e bursave shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) zotërohen dhe menaxhohen nga NYC Kids RISE, zotërimi i kësaj llogarie nuk ndikon në aplikimin e një nxënësi ose në qiranë e një familjeje për banesat e ofruara nga NYCHA-së ose për ndihmën me banesat përmes Departamentit për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Banesave të Qytetit të Nju Jorkut (NYC Department of Housing Preservation and Development). Nëse një familje kursen para në vetë llogarinë e saj të kursimeve për kolegji

dhe karrierë, ky aset mund të merret në konsideratë gjatë procesit të aplikimit. Për më shumë informacion se si llogaria e kursimeve mund të ndikojë në përfitimet nga fonte publik, vizitoni: [nyckr.org/infomaterials-faq](https://nyckr.org/infomaterials-faq) dhe shikoni programi "Kurse para për kolegjin dhe përfitimet nga fondet publike" (The Save for College Program and Public Benefits).

## 33. Si ndikon zotërimi i një llogarie bursash shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) në kualifikimin për ndihmë financiare?

Duke qenë se llogaritë e bursave shkollore të qytetit të Nju Jorkut zotërohen dhe menaxhohen nga NYC Kids RISE, zotërimi i një llogarie **nuk** ndikon në të drejtën e një nxënësi për të marrë ndihmë financiare, ndërkohë që paratë janë në llogari. Ndërsa fëmija juaj i afrohet kolegjit ose formimit profesional, NYC Kids RISE do të ofrojë më shumë informacion mbi mënyrën se si përdorimi i fondeve të llogarisë së bursës për arsimin e fëmijës tuaj mund të ndikojë ose jo në të drejtën për ndihmë financiare, pasi këto para të jenë shpenzuar. Mund të ndikojë ose jo.

Nëse një familje kursen para në llogarinë e saj të kursimeve për kolegji, këto kursime mund të ndikojnë në paketën e ndihmës financiare të nxënësit. Për më shumë informacion mbi mënyrën se si kontributi në llogarinë tuaj të kursimeve për kolegji dhe karrierë mund të ndikojë në të drejtën e nxënësit për ndihmë financiare sipas rregullave aktuale të ndihmës financiare, vizitoni: [nyckr.org/infomaterials-faq](https://nyckr.org/infomaterials-faq) dhe për më shumë informacion, shkarkoni broshurën e programit "Kurse para për kolegjin dhe ndikimi në ndihmën e ardhshme financiare" ("The Save for College Program and Impact on Future Financial Aid"). Vini re se këto rregulla për ndihmën financiare ndryshojnë shpesh me kalimin e kohës.

## 34. A mund të përdoren fondet e bursës për programe të arsimit special?

Llogaritë e bursave shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account), në përputhje me rregullat e NY 529 *Direct Plan*, mund të përdoren për të mbuluar shërbime të caktuara për nxënës me nevoja të veçanta lidhur me regjistrimin dhe frekuentimin e institucioneve pjesëmarrëse arsimore. Disa institucione pjesëmarrëse ofrojnë programe dhe mbështetje për nxënës me nevoja të veçanta. Për të parë cila shkollë ose program i caktuar është pjesëmarrës, vizitoni: [studentaid.gov/understand-aid/eligibility/requirements/intellectual-disabilities](https://studentaid.gov/understand-aid/eligibility/requirements/intellectual-disabilities).

Për më shumë informacion mbi llojet e shpenzimeve të pranueshme sipas NY 529 *Direct Plan*, duke përfshirë edhe ata nxënës me nevoja të veçanta, kontaktoni NY 529 në nr. 877-NYSAVES ([877-697-2837](tel:877-697-2837)) ose vizitoni: [nysaves.org](https://nysaves.org).

## 35. Po nëse fëmija im nuk frekuenton kolegjin?

Nëse një fëmijë që merr pjesë në programin “Kurse para për kolegjin” (Save for College Program) nuk frekuenton një kolegji ose universitet, paratë në llogarinë e bursës shkollore të tij nga qyteti i Nju Jorkut (NYC Scholarship Account), mund të përdoren gjithsesi për tarifa dhe shpenzime të kualifikuara në shkolla profesionale dhe teknike, programe pjesëmarrëse të zanateve dhe të diplomave në internet. Nëse një nxënës në program nuk i përdor fondet e llogarisë së bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut për të mbuluar shpenzimet e pranueshme të arsimit të lartë në ndonjë institucion pjesëmarrës brenda 20 viteve nga përfundimi i kopshtit, fondet i kthehen NYC Kids RISE për të mbështetur nxënës të tjerë të ardhshëm në programin “Kurse para për kolegjin”.

### LLOGARIA JUAJ PERSONALE E KURSIMEVE PËR KOLEGJ

## 36. Cilat janë opsionet e mia për të kursyer përmes programit “Kurse para për kolegjin” (Save for College Program)?

Ekzistojnë mënyra të ndryshme për të kursyer për kolegjin dhe formimin profesional. Programi “Kurse para për kolegjin” ofron dy opsione për hapjen e një llogarie kursimi për kolegji dhe karrierë që mund të lidhet me llogarinë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) për fëmijën tuaj:

1. Një llogari NY 529 *Direct Plan*; një lloj llogarie investimi e krijuar posaçërisht për t’i ndihmuar familjet të kursejnë për kolegji dhe formim profesional; dhe
2. Një llogari kursimi tradicionale nga Amalgamated Bank, e quajtur “Llogaria Bankare nga Amalgamated për kurse për kolegjin” (Amalgamated Save for College Bank Account).

Ka edhe mënyra të tjera për të kursyer përveç këtyre opsioneve. Ju mund të dëshironi të eksploroni alternativa të tjera për të parë nëse ato mund të jenë më të përshtatshme për nevojat ose rrethanat tuaja të veçanta. Megjithatë, veçoritë dhe përfitimet specifike që ofron programi “Kurse para për kolegjin” për llogaritë e kursimeve për kolegji dhe formim profesional janë të vlefshme vetëm për opsionet e ofruara përmes programit. NYC Kids RISE nuk ofron këshilla për investime dhe nuk rekomandon ndonjë llogari të caktuar kursimi për kolegji.

Për më shumë informacion rreth këtyre opsioneve dhe si të hapni një llogari, vizitoni: [nyckr.org/options-faq](https://nyckr.org/options-faq); kontaktoni NYC Kids RISE, duke telefonuar në nr. [833-543-7473](tel:833-543-7473) ose duke dërguar email në [info@nyckidsrise.org](mailto:info@nyckidsrise.org), ose frekuentoni në një nga seancat e ardhshme virtuale të programit në [nyckr.org/events-faq](https://nyckr.org/events-faq).

## 37. Si ndryshon një llogari 529 nga ajo bankare?

Llogaritë bankare dhe ato 529 janë të dyja opsione për të kursyer para për kolegji dhe formim profesional. Megjithatë, llogaritë 529 investohen në tregjet financiare, gjë që sjell si rreziqe ashtu edhe mundësi më të mëdha për fitime. Nga ana tjetër, një llogari kursimi në një bankë më tradicionale, shpesh është e sigurtuar nga Korporata Federale e Sigurimeve të Depozitave (Federal Deposit Insurance Corporation, FDIC) deri në shumën prej 250,000 dollarësh.<sup>2</sup> Kontributet në një llogari 529, përfshirë NY 529 *Direct Plan*, gjithashtu gjenerojnë disa përfitime tatimore që zakonisht nuk i ofrojnë shumica e llogarive bankare.

Llogaritë 529 janë krijuar posaçërisht për familjet që kursejnë për arsimin e fëmijëve pas shkollës së mesme. Nëse një shumë e tërhequr nga llogaria 529 përdoret për diçka tjetër përveç shpenzimeve të kualifikuara arsimore, pjesa e fitimeve nga tërheqja mund të tathohet si të ardhurat e zakonshme dhe familjet mund të marrin një gjobë tatimore prej 10% të fitimeve. Tërheqja gjithashtu mund t’i nënshtrohet taksave shtetërore dhe lokale.

## 38. Po nëse tashmë e kam një llogari 529 të hapur për fëmijën tim?

Nëse keni tashmë një llogari NY 529 *Direct Plan* me fëmijën tuaj si përfitues, do të keni mundësinë ta lidhni atë llogari ekzistuese me llogarinë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) për fëmijën tuaj dhe të shikoni gjendjen e të dyja llogarive në një vend të vetëm. Për më shumë informacion mbi mënyrën e lidhjes së llogarive, vizitoni: [nyckr.org/infomaterials-faq](https://nyckr.org/infomaterials-faq) dhe lexoni broshurën “Si të hapni një llogari NY 529 *Direct Plan*” (“How to Open a 529 Direct Plan Account”).

Nëse keni një llogari 529 në një plan tjetër shtetëror 529, mund të vazhdoni ta përdorni atë llogari, por ajo nuk kualifikohet për veçoritë dhe përfitimet specifike që ofron programi “Kurse para për kolegjin” (Save for College Program).

Programi “Kurse para për kolegjin” i NYC Kids RISE nuk ofron këshilla për investime dhe ky dokument nuk përmban ndonjë rekomandim në lidhje me përshtatshmërinë e ndonjë investimi.

<sup>2</sup>Kufiri standard i mbulimit të sigurimit të depozitave është 250,000 dollarë për depozitues, për çdo bankë të sigurtuar nga FDIC, për çdo kategori të pronësisë së llogarisë. Depozitat e mbajtura në kategori të ndryshme pronësie janë të siguruara veçmas, deri në të paktën 250,000 dollarë edhe nëse mbahen në të njëjtën bankë.

### 39. Çfarë ndodh nëse një nxënës nuk është në gjendje të përdorë llogarinë e tij NY 529 Direct Plan për shpenzime të kualifikuara?

Tërheqjet nga llogaritë 529 që nuk përdoren për shpenzime të kualifikuara i nënshtrohen tatimit federal dhe atyre shtetërore dhe lokale për fitimet, si dhe një gjobë federale prej 10%. Megjithatë, tërheqjet për shkak të aftësive të kufizuara i nënshtrohen tetimeve federale dhe përkatëse shtetërore/ lokale për fitimet, por jo gjobës federale prej 10%.

### 40. Si duhet të mendoj për kursimet për kolegji dhe karrierë nëse kam prioritete të tjera për kursim ose borxhe?

Situata financiare ndryshon nga personi në person. Për ndihmë individuale, merrni në konsideratë të kërkonti këshilla nga një ekspert në fushën e investimeve ose vizitoni një nga Qendrat e Fuqizimit Financiar (Financial Empowerment Center) të qytetit të Nju Jorkut për këshillim financiar falas. Në Qendrat e Fuqizimit Financiar të qytetit, mund të takoheni një për një me një konsulent financiar ekspert që mund t'ju ndihmojë të krijoni një buxhet, të kurseni dhe të planifikoni për të ardhmen, përfshirë arsimin e lartë. Konsulentët gjithashtu mund t'ju ndihmojnë të reduktoni borxhin, të përmirësoni kreditin, të hapni një llogari bankare dhe më shumë. Për të rezervuar një takim në një nga qendrat pranë jush, vizitoni: [nyc.gov/talkmoney](http://nyc.gov/talkmoney).

### 41. Çfarë lloj mundësisë për udhëzime financiare ofron programi "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program)?

NYC Kids RISE ofron mjete dhe informacion për familjet që të zhvillojnë planet e tyre për kurse për kolegji dhe karrierë. Kjo përfshin seanca dhe aktivitete në shkollën e fëmijës suaj, ku mund të mësoni më shumë rreth opsioneve të kurseve për kolegji dhe burimeve të fuqizimit financiar në dispozicion. Një kalendar me seanca virtuale të ardhshme të programit "Kurse para për kolegjin" mund ta gjeni në [nyckr.org/events-faq](http://nyckr.org/events-faq).

NYC Kids RISE ka bashkëpunuar gjithashtu me shkollat publike të qytetit të Nju Jorkut për të zhvilluar kurrikula emocionuese dhe interaktive për edukimin financiar të nxënësve pjesëmarrës.

Udhëzuesit për Zgjerimin e Kurrikulës (Curriculum Extension Guides) së programit "Kurse para për kolegjin" nga NYC Kids RISE janë një eksplorim emocionues dhe interaktiv i koncepteve të krijuara për të mbështetur edukimin financiar për të gjitha klasat pjesëmarrëse. Kjo përfshin zgjerime të kurrikulës për t'u përfshirë në klasat K-3 në të gjithë qytetin dhe në klasat K-5 në Distriktin Shkollor 30. Zgjerimet ofrojnë një burim për shkollat dhe mësuesit për të përfshirë mësimet

rreth parave, kurseve dhe mënyrës se si këto lidhen me të ardhmen akademike dhe profesionale të nxënësve.

Përmbajtja e këtyre mësimëve përfshin përshtatje nga programi "Money Smart" i FDIC-it dhe është harmonizuar me standardet dhe kurrikulat e ndryshme. Duke qenë se ky është një udhëzues mbi kurrikulat, mësimet janë krijuar për t'u modifikuar sipas nevojës. Kjo kurrikulë nuk është menduar të përdoret e vetme, por mund të integrohet në lëndë të ndryshme përmes aktiviteteve që e pasurojnë dhe e zgjerojnë, për t'i ndihmuar nxënësit të ndërtojnë një themel për t'u shndërruar në të rritur që kanë siguri financiare.

Për pyetje lidhur me zgjerimet e kurrikulës, mund të dërgoni email në: [savingtogether@schools.nyc.gov](mailto:savingtogether@schools.nyc.gov).

### 42. Si mund të hap një llogari kursimi për kolegji dhe formim profesional?

Për udhëzime dhe mbështetje, vizitoni: [nyckr.org/options-faq](http://nyckr.org/options-faq) ose frekuentoni një seminar virtual të programit "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program) [nyckr.org/events-faq](http://nyckr.org/events-faq). Ju gjithashtu mund të kontaktoni linjën telefonike të NYC Kids RISE, duke telefonuar në nr. [833-543-7473](tel:833-543-7473) ose duke dërguar email në [info@nyckidsrise.org](mailto:info@nyckidsrise.org).

### 43. Si mund të di cili opsion kursimi për kolegjin dhe formimin profesional është më i miri për mua?

Ekzistojnë shumë mënyra për të kursyer për kolegjin ose formimin profesional. Për mjete dhe informacion për të krahasuar opsionet tuaja, vizitoni: [nyckr.org/options-faq](http://nyckr.org/options-faq) ose frekuentoni një seminar virtual të programit "Kurse para për kolegjin" (Save for College Program) në [nyckr.org/events-faq](http://nyckr.org/events-faq). Për informacion të detajuar rreth NY 529 Direct Plan, vizitoni: [nysaves.org](http://nysaves.org) ose telefononi në nr. [877-NYSAVES \(877-697-2834\)](tel:877-NYSAVES).

Për të mësuar më shumë rreth "Llogarisë bankare për kurse për kolegjin nga Amalgamated", vizitoni një nga degët e Amalgamated Bank në [amalgamatedbank.com/find-a-branch-or-atm](http://amalgamatedbank.com/find-a-branch-or-atm) ose telefononi [800-662-0860](tel:800-662-0860).

Shumica e shteteve të tjera ofrojnë gjithashtu planet e tyre 529 për kurse, dhe banka të tjera janë në dispozicion për qëllime kursimi. Të gjitha këto mund t'ju ndihmojnë të arrini qëllimet tuaja të kursimit për kolegji dhe karrierë. Megjithatë, këto opsione të tjera nuk janë të lidhura me programin "Kurse para për kolegjin". NYC Kids RISE nxit çdo familje të eksplorojë opsione të ndryshme për kurse për kolegji dhe karrierë dhe nuk ofron këshilla për investime. Ju duhet të merrni parasysh rrethanat tuaja përpara se të kurseni ose investoni dhe mund të dëshironi të konsultoheni me një ekspert investimesh.

## 44. A duhet të hap llogarinë time personale për kursime për kolegji dhe karrierë që të regjistrohesh në program?

Jo, nuk është e nevojshme të hapni një llogari tuajën personale për kursime për kolegji dhe formim profesional ose të depozitoni para, që fëmija juaj të jetë i regjistruar në programin “Kurse para për kolegjin” (Save for College Program) dhe të ketë një llogari burse shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account). Megjithatë, NYC Kids RISE nxit çdo familje të eksplorojë opsionet e saj dhe të hapë një llogari personale kursimi për kolegji dhe karrierë për fëmijën e vet. Për mbështetje, kontaktoni NYC Kids RISE, duke telefonuar në [833-543-7473](tel:833-543-7473); duke dërguar email në [info@nyckidsrise.org](mailto:info@nyckidsrise.org) ose duke marrë pjesë në një seminar virtual të programit “Kurse para për kolegjin” [nyckr.org/events-faq](https://nyckr.org/events-faq).

### PËRPUTHJA E KURSIMEVE

## 45. Si funksionon përputhja e kursimeve?

Duke filluar nga dita e parë e klasës së parë, familjet që kanë arritur “3 gurët e themelit” (3 Building Blocks) do të kualifikohen për “Të njëjtën shumë të depozituar nga ju”. NYC Kids RISE do të ofrojë po aq sa depozitoni në llogarinë tuaj të lidhur të kursimeve për kolegji dhe karrierë dollar për dollar, deri në shumën prej 100 dollarësh.

Për sa kohë që keni lidhur një llogari kursimi me llogarinë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) për fëmijën tuaj (Guri 2 i themelit/Building Block 2), NYC Kids RISE mund të gjurmojë depozitat e familjes suaj dhe të përputhë të njëjtën shumë automatikisht.

Si shpërblimet për “Gurët e themelit” ashtu edhe ato të përputhjes së kursimeve janë të disponueshme deri në klasën e pestë, me përjashtim të nxënësve pjesëmarrës në klasën e pestë ose më të rritur, që u regjistruan në program, ndërsa frekuentonin një nga 39 shkollat pilot në Distriktin 30 gjeografik. Këta nxënës mund të vazhdojnë të fitojnë shpërblime për arritjen e “3 gurëve të themelit” dhe përputhjen e shumës së kursimeve deri në ditën e fundit të klasës së tetë. Në këtë kohë, kjo nuk vlen për fëmijët që kanë filluar kopshtin për vitin shkollor (school year) 2021-2022; klasën e parë për 2022-2023; klasën e dytë për 2023-2024; klasën e tretë për 2024-2025 ose klasën e katërt për 2025-2026 që janë të kualifikuar vetëm për shpërblimet deri në fund të klasës së pestë.

## 46. Si do ta di nëse llogaria e fëmijës sime ka marrë shumën e përputhjes së kursimeve?

Për të parë paratë që NYC Kids RISE ka shtuar në llogarinë e bursës shkollore të qytetit të Nju Jorkut (NYC Scholarship Account) të fëmijës suaj, hyni përsëri në “Savings Tracker” në [nyckr.org/login-faq](https://nyckr.org/login-faq) dhe lëvizni poshtë në seksionin “Llogaritë tuaja të kursimeve për kolegjin dhe karrierën”. (“Your College and Career Savings Accounts”). Klikoni në skedën “Scholarship Account” (Llogaria e bursës) dhe lëvizni poshtë për të parë historikun e transaksioneve. Do të shihni një transaksion me emërtimin “Savings Match” (Përputhja e kursimeve) për secilën depozitë të pranueshme në llogarinë tuaj të lidhur të kursimeve për kolegji.

## 47. Sa është shuma që duhet të filloj të kursej rregullisht në llogarinë e kursimeve për kolegji dhe karrierë që kam për fëmijën tim?

Çdo situatë ndryshon nga familja në familje. Kursimet për kolegji dhe karrierë janë një pjesë e rëndësishme e shëndetit të përgjithshëm financiar të një familjeje. Vendimi për shumën që doni të kurseni për kolegji ose formim profesional varet nga rrethanat tuaja individuale financiare, duke përfshirë të ardhurat, asetet, borxhet, shpenzimet e zakonshme, përfitimet nga fondet publike dhe kreditin. NYC Kids RISE nxit çdo familje të fillojë të kontribuojë me çdo shumë që e sheh të përshtatshme. Nëse filloni për të kursyer, ndërkohë që fëmija juaj është ende i vogël, kjo mund të jetë shumë e leverdishme, pavarësisht nga shuma.

Për mbështetje individuale dhe falas për të përshtatur kursimet me gjendjen tuaj të përgjithshme financiare, merrni parasysh të vizitoni një nga Qendrat e Fuqizimit Financiar (Financial Empowerment Center) të qytetit të Nju Jorkut që ndodhen në të gjithë qytetin. Në Qendrat e Fuqizimit Financiar, mund të takoheni një për një me një konsulent financiar ekspert që mund t’ju ndihmojë të reduktoni borxhin, të përmirësoni kreditin tuaj, të krijoni një buxhet, të hapni një llogari bankare, të kurseni dhe të planifikoni për të ardhmen dhe më shumë. Mund të merrni gjithashtu informacion rreth kursimit për arsimin e lartë dhe të karrierës së fëmijës suaj dhe të krijoni një plan për të filluar nga kursimi.

Për të rezervuar një takim në një nga këto qendra pranë jush, telefononi 311 ose vizitoni: [nyc.gov/talkmoney](https://nyc.gov/talkmoney).

---

*NYC Kids RISE është një organizatë jofitimprurëse që bashkëpunon me qytetin e Nju Jorkut dhe shkollat publike të tij (Departamenti i Arsimit i Qytetit të Nju Jorkut/NYC Department of Education) për të menaxhuar programin “Kurse para për kolegjin” (Save for College Program).*